

Draft

Bazuar në nenin 39. paragrafi 2. dhe nenin 59. paragrafi 2. në lidhje me nenin 157. paragrafi 2. të Ligjit për mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 027/13, 001/15, 042/15, 047/15, 056/16, 066/16, 001/17, 031/17, 042/17, 050/17, 059/21, 145/21.), neni 38. paragrafi 1. pika 2. e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 002/18, 034/19, 038/20, 050/22, dhe 084/22.), dhe neni 58. paragrafi 1. pika 2. e Statutit të Komunës së Ulqinit (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi” – Rregulloret komunale” Nr. 48/19.), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në seancën e mbajtur më __.03. 2024. solli

VENDIM

për ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit për të drejtat nga mbrojtja sociale dhe e ajo e fëmijëve

Neni 1.

Në Vendimin për të drejtat nga mbrojtja sociale dhe e fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi” – Rregullorja komunale nr. 4/19.)

Neni 4. paragrafi 1. ndryshohet si vijon:

“Procedurën për ushtrimin e të drejtave nga mbrojtja sociale dhe e fëmijëve të përcaktuara me këtë vendim e udhëheq organi i qeverisjes lokale – Sekretariati për kulturë, sport, rini dhe veprimtari shoqërore (në tekstin e mëtejme Sekretariati).

Neni 2.

Neni 8. ndryshohet si vijon:

“Shuma e mjeteve për ushtrimin e të drejtës së ndihmës financiare të njëherëshme nuk mund të jetë më e lartë se 200.00. (dyqind euro).

Neni 3.

Neni 9. paragrafi 3. ndryshohet si vijon:

“Në procesin e përfitimit të ndihmes financiare të njëherëshme në kuptim të këtij Vendimi, të ardhura të një individi, përkatësisht të një anëtari të familjes, nuk konsiderohen të jenë: pensioni invalidor personal, kompensimi për përkujdesje dhe ndihmë, shtesa për fëmijë, kompensimi për fëmijën e porsalindur, gjegjësisht kompensimi për lindjen e fëmijës, për personin që është në evidencën e Entit për Punësim, studentit të rregullt, shpërblimi i largimit në pension, kompensimi për personat me invaliditet, siguria materiale, etj.

Neni 4.

Neni 13, paragrafi 3, ndryshohet si vijon:

„Kompensimi nga paragrafi 1. i këtij neni paguhet në mënyrë të njëherëshme në shumën prej 140.00. euro (njëqind e dyzet euro).

Neni 5.

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga data e botimit në Gazetën Zyrtare të Malit të Zi - rregulloret komunale.

KUVENDI KOMUNAL I ULQINIT

Numër: 02-016/24-
Ulqin, 2024

KRYETARI
Ardijan Mavriq

Arsyetimi

Baza ligjore për marrjen e këtij vendimi gjendet në nenin 39. paragrafi 2. të Ligjit për Mbrojtjen Sociale dhe të Fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 027/13, 001/15, 042/15, 047/15, 056/16, 066/16, 001/17, 031/17, 042/17, 050/17, 059/21, 145/21.) i cili parashikon që Komuna, në përputhje me mundësitë e saj financiare, mund të sigurojë përfitime materiale nga mbrojtja sociale, si: grante të njëhershme; subvencionet në pagesën e shërbimeve komunale të ofruara nga ndërmarrjet publike të themeluara nga komuna dhe përfitime të tjera materiale nga mbrojtja sociale. Llojet e përfitimeve materiale, kushtet më të detajuara, mënyrën dhe procedurën për realizimin e të drejtës nga paragrafi 1. i këtij neni i përcakton organi kompetent i komunës. Për më tepër, sipas nenit 59. dhe 157. paragrafi 2. Komuna në përputhje me mundësitë e saj financiare, mund të sigurojë përfitime materiale nga mbrojtja e fëmijëve, si p.sh.: ndihma për fëmijën e porsalindur; ndihmë për blerjen e mjeteve shkollore dhe përfitime të tjera materiale. Llojet e përfitimeve materiale, kushtet më të detajuara, mënyra dhe procedura për realizimin e të drejtave nga paragrafi 1. i këtij neni i përcakton organi kompetent komunal, përkatësisht kriteret dhe standardet për caktimin e çmimit të shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve, të cilat financohen nga buxhetin komunal, i përcakton organi kompetent komunal. Arsyet e këtij vendimi janë fakti se individët apo familjet në Komunën e Ulqinit të cilët kanë nevojë për ndihmë financiare të njëhershme ndodhen në gjendje jashtëzakonisht të vështirë financiare për shkak të pamundësisë për të përmbushur nevojat elementare jetësore, sëmundjes, paaftësisë për punë dhe disa janë në kufi të ekzistencës si pasojë e inflacionit të lartë. Gjithashtu, duke pasur parasysh amendamentet e dorëzuara nga këshilltarët në komisionin kompetent për financa dhe në Kuvendin Komunal, është përcaktuar lartësia e kompensimit të njëhershëm për një të porsalindur të rritet nga shuma prej 70.00 euro në shumën prej 140.00 euro.

Sekretariati për kulturë, sport, rini dhe veprimtari shoqërore